



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI**

Nr. 340 Prot.

Tiranë, më 31/3.2020

**VENDIM**  
Nr. 21, Datë 31/3/2020

**MBI**

**SHKURTIMIN E FONDEVE TE BUXHETIT TE KLSH-SE TË  
SHPENZIMEVE OPERATIVE DHE TE INVESTIMEVE PËR VITIN  
2020 DHE KALIMIN E TYRE NE FAVOR TE BUXHETIT TE SHTETIT  
PER PERBALLIMIN E SITUATES SE FATKEQSISE NATYRORE TE  
COVID-19**

Bazuar në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; si dhe në analizën e situatës buxhetore të kryer në kuadrin e situatës së krijuar nga gjëndja e fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19, si dhe bazuar në *rishikimin e prioriteteteve* në drejtim të orientimit të burimeve buxhetore në aktivitetet dhe veprimtaritë *më të domosdoshme në kushtet e një regjimi të rreptë të administrimit ekonomik dhe eficient* te fondeve te shpenzimeve operative dhe të investimeve për vitin 2020, në vijim të Vendimit të Kryetarit nr. 19 datë 27.03.2019 “Për anulimin dhe pezullimin e procedurave të prokurimeve fondeve për investime dhe operative për vitin 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19” dhe Urdhrit të Kryetarit nr. 41, datë 20.03.2020 “Për kontributin financiar të Kryetarit të KLSH-së në kuadër të masave për të marra për shkak të COVID -19” :

**VENDOSA :**

**1.** Fondet e investimeve me objekt “Blerje makina” në vlerën prej 9700 mijë lekë që përfaqëson 100% të shpenzimeve të planifikuara për këtë zë të investimeve pakësohen dhe do të kalojnë në favor të buxhetit për përballimin e situatës së fatkeqësisë natyrore COVID-19. Me Vendimin e Kryetarit nr. 19 datë 27.03.2019 “Për anulimin dhe pezullimin e procedurave të prokurimeve fondeve për investime dhe operative për vitin 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19” *KLSH ka kërkuar anulimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit të fondeve nga Ministria e Brendshme Agjencia e Blerjeve të përqendruara*) me objekt prokurimi “Blerje makina” vlera 9 700 mijë lekë.

2. Fondet e investimeve me objekt "Blerje pajisje kompjuterike" ne vlerën fillestare prej 7 742 mijë lekë pakësohen në vlerën 2 240 mijë leke, që përfaqëson rreth 30 % te fondit për këtë zë të investimeve.

3. Fondet buxhetore të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes pakësohen në vlerën 9 000 mijë lekë ose në 10% të buxhetit vjetor në zërat si më poshtë:

3.1 Për shpenzimet e "Udhëtim e dieta brenda vendit" pakësim, vlera 2 500 mijë lekë.

3.2 Për shpenzimet "Udhëtim e dieta jashtë vendit" pakësim, vlera 3 500 mijë lekë.

3.3 Për shpenzime "Transporti" pakësim, vlera 796 mijë lekë.

3.4 Për shpenzime "Materiale zyre dhe te përgjithshme" pakësim, vlera 784 mijë lekë.

3.5 Për Shpenzime "Publikime libra" pakësim, vlera 270 mijë lekë.

3.6 Për shpenzime "Mirëmbajtje" pakësim, vlera 700 mijë lekë.

3.7 Për Shpenzime "Qiramarrje e pritje përcjellje" pakësim, vlera 450 mijë lekë.

4. Sekretari i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave, për kryerjen e veprimeve për pakësimin e fondeve në favor të buxhetit për përballimin e fatkeqësisë natyrore COVID-19, në shumën totale **20 940 mijë lekë** nga të cilat 11 940 mijë lekë në zërin investime që përfaqëson rreth 42% të fondeve të investimeve me financim të brendshëm dhe **9 000 mijë lekë** në zërin shpenzime operative ose 10% të totalit të fondeve për këtë zë buxhetor.

Në zërin paga mbështetur në Urdhrin e Kryetarit nr. 41, datë 20.03.2020 "Për kontributin financiar te Kryetarit te KLSH-së në kuadër të masave për të marra për shkak të COVID -19" preket paga e Kryetarit, minimalisht për periudhën tre muaj ose deri në fund të vitit ne varësi të situatës dhe kalimin e kontributit financiar në fondin antiCovid 19.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Sekretari i Përgjithshëm dhe Sektori i Financës.

6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Bujar LESKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
K R Y E T A R I

Nr. 340/prot.  
1

Tiranë, më 02/4/2020

**Lënda:** Mbi shkurtimin e fondeve buxhetore te KLSH-se ne favor te buxhetit shtetit për përballimin e fatkeqësisë natyrore Covid-19.

**Drejtuar:**

**Z. Arben AHMETAJ, MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN**

**Zj. ANILA DENAJ, MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Per dijani: Zj. Milva EKONOMI**  
**KRYETAR I KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE**  
**Z. Anastas ANGJELI**  
**SEKRETAR I KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE**  
**Z. Arben ELEZI**  
**ZV/KRYETAR I KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE**

**KUVENDI I SHQIPËRISË**

**TIRANË**

Kontrolli i Lartë i Shtetit në kuadrin e situatës së krijuar nga gjendja e fatkeqësisë natyrore për shkak të COVID-19, ndërromori masa për analizën e situatës buxhetore *duke rishikuar prioritetet* në drejtim të orientimit të burimeve buxhetore në aktivitetet dhe veprimtaritë *më të domosdoshme në kushtet e një regjimi të rreptë të administrimit ekonomik* dhe eficient te fondeve.

Me Vendimin e Kryetarit nr. 21 datë 31.03.2020 “Mbi shkurtimin e fondeve te buxhetit te KLSH-se, të shpenzimeve operative dhe të investimeve për vitin 2020 dhe kalimin e tyre ne favor te buxhetit te shtetit për përballimin e situatës se fatkeqësisë natyrore te COVID-19”, në vijim të Vendimit të Kryetarit nr. 19 datë 27.03.2019 “Për anulimin dhe pezullimin e procedurave të prokurimeve fondeve për investime dhe operative për vitin 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19” dhe Urdhrit te Kryetarit nr. 41, datë 20.03.2020 “Për kontributin financiar te Kryetarit te KLSH-së në kuadër të masave për të marra për shkak të COVID -19” është vendosur pakësimi i fondeve buxhetore të KLSH-së si më poshtë vijon:

1. Fondet e investimeve me objekt "Blerje makina" në vlerën prej 9700 mijë lekë, që përfaqëson 100% të shpenzimeve të planifikuara për këtë zë të investimeve, pakësohen dhe do të kalojnë në favor të buxhetit për përballimin e situatës së fatkeqësisë natyrore COVID-19. Me vendimin e Kryetarit nr. 19 datë 27.03.2019 "Për anulimin dhe pezullimin e procedurave të prokurimeve fondeve për investime dhe operative për vitin 2020, për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19" KLSH me shkresën nr 128/5 datë 27.03.2020 ka kërkuar anulimin e menjëhershëm të procedurës së prokurimit të fondeve nga Ministria e Brendshme Agjencia e Blerjeve të përqendruara) me objekt prokurimi "Blerje makina" vlera 9 700 mijë lekë.

2. Fondet e investimeve me objekt "Blerje pajisje kompjuterike" në vlerën fillestare prej 7 742 mijë lekë pakësohen në vlerën 2 240 mijë leke, që përfaqëson rreth 30 % të fondit për këtë zë të investimeve.

3. Fondet buxhetore të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes pakësohen në vlerën 9 000 mijë lekë ose në 10% të buxhetit vjetor në zërat si më poshtë:

3.1 Për shpenzimet e "Udhëtim e dieta brenda vendit" pakësim, vlera 2 500 mijë lekë.

3.2 Për shpenzimet "Udhëtim e dieta jashtë vendit" pakësim, vlera 3 500 mijë lekë.

3.3 Për shpenzime "Transporti" pakësim, vlera 796 mijë lekë.

3.4 Për shpenzime "Materiale zyre dhe të përgjithshme" pakësim, vlera 784 mijë lekë.

3.5 Për Shpenzime "Publikime libra" pakësim, vlera 270 mijë lekë.

3.6 Për shpenzime "Mirëmbajtje" pakësim, vlera 700 mijë lekë.

3.7 Për Shpenzime "Qiramarrje e pritje përcjellje" pakësim, vlera 450 mijë lekë.

4. Në zërin "Paga" mbështetur në Urdhrin e Kryetarit nr. 41, datë 20.03.2020 "Për kontributin financiar të Kryetarit të KLSH-së, në kuadër të masave për të marra për shkak të COVID -19" janë kryer ndalesat në masën 50 % të pagës së Kryetarit që do të zgjasë minimalisht për periudhën tre muaj ose deri në fund të vitit në varësi të situatës dhe është proceduar me kalimin e kontributit financiar në fondin ANTI-COVID 19.

5. Për sa më lart, KLSH kërkon bashkëpunimin me Ministrinë e Financave, për kryerjen e veprimeve për pakësimin e fondeve në favor të buxhetit për përballimin e fatkeqësisë natyrore COVID-19, në shumën totale **20 940 mijë lekë** nga të cilat 11 940 mijë lekë në zërin investime që përfaqëson rreth 42% të fondeve të investimeve me financim të brendshëm dhe **9 000 mijë lekë** në zërin shpenzime operative ose 10% të totalit të fondeve për këtë zë buxhetor.

Duke Ju falënderuar për frymën bashkëpunuese,

**KRYETAR**

**Bujar LESKAJ**

